



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

**THIRRJE Nr.2 PËR PROJEKT-PROPOZIME NË ART, KULTURË, TRASHËGIMI  
KULTURORE DHE SPORT PËR VITIN 2026**

Bashkia Durrës, e angazhuar në promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore, turizmit dhe sportit, si dhe e udhëhequr nga vizioni për ta shndërruar Durrësin në një qendër të rëndësishme kulturore, turistike dhe komunitare, shpall **Thirrjen nr. 2 për projekt-propozime për vitin 2026.**

Nëpërmjet kësaj thirrjeje, Bashkia Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Drejtorinë e Turizmit, dhe dhe Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile synon të nxisë dhe të mbështesë realizimin e aktiviteteve cilësore në fushën e artit, kulturës, turizmit, trashëgimisë, gastronomisë dhe promovimit të produkteve vendase në të gjithë territorin e saj.

Kjo thirrje ka për qëllim përzgjedhjen e një ose disa subjekteve që do të paraqesin konceptin, programin, metodologjinë dhe kapacitetet e tyre për organizimin e një ose disa aktiviteteve kulturore, artistike, turistike dhe promovuese në territorin e Bashkisë Durrës.

Aplikuesit mund të paraqesin propozime për një aktivitet të vetëm, për disa aktivitete ose për të gjithë kalendarin e parashikuar në këtë thirrje. Bashkia Durrës rezervon të drejtën të përzgjedhë një ose disa subjekte fituese, në varësi të cilësisë së propozimeve, kapaciteteve organizative, përshtatshmërisë së propozimit me aktivitetin përkatës dhe fondit të miratuar në dispozicion.

### **1. Qëllimi i thirrjes**

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështetja e organizimit të aktiviteteve që promovojnë Durrësin si destinacion turistik, kulturor, historik dhe agro-ushqimor, duke krijuar një traditë të përvitshme eventesh në qytet dhe në njësitë administrative rurale.

Aktivitetet synojnë të nxisin pjesëmarrjen e komunitetit, promovimin e trashëgimisë lokale, përfshirjen e artistëve, fermerëve, artizanëve, operatorëve turistikë dhe bizneseve vendase, si dhe krijimin e një kalendari të qëndrueshëm aktiviteteve që kontribuon në zhvillimin kulturor, turistik dhe ekonomik të territorit.

### **2. Aktivitetet objekt i thirrjes**

Propozimet mund të paraqiten për organizimin e plotë ose të pjesshëm të aktiviteteve kulturore dhe/apo artistike të ndara në dy kategori, si më poshtë vijon:

#### **A. Mbrëmje gala “Durrës Turizm Awards 2026”, Data: 15 shtator 2026**

Eventi Mbrëmje Gala, e cila do të organizohet në mbyllje të sezonit turistik veror 2026 konceptohet si një aktivitet ceremonial, artistik dhe promovues, në formën e një spektakli përmyllës të sezonit turistik veror 2026. Eventit duhet të ndërthurë performanca artistike,

muzikë, elementë vizualë, materiale promovuese për Durrësin dhe momente ceremoniale të ndarjes së çmimeve/mirënjohjeje për aktorët lokal që kanë kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

## **B. Fshati n`Festë - “Traditë, Shije dhe Takim mes Brezash”**

Ky event përfshin organizimin e festave kulturore, turistike, gastronomike dhe agro-ushqimore në njësitë administrative rurale të Bashkisë Durrës, me fokus promovimin e trashëgimisë, folklorit, artizanatit, produkteve vendase, gastronomisë tradicionale dhe bashkëpunimit ndërmjet brezave.

Eventet e parashikuara janë:

- **Njësia Administrative Rrashbull** – 13 gusht 2026;
- **Njësia Administrative Ishëm** – 17 gusht 2026;
- **Njësia Administrative Manëz** – 21 gusht 2026;
- **Njësia Administrative Sukth** – 30 gusht 2026;
- **Njësia Administrative Katund i Ri** – 4 shtator 2026.

Çdo aktivitet duhet të përfshijë, sipas specifikës së zonës, elementë të tillë si panair agro-ushqimor, ekspozim të produkteve vendase, artizanat, program artistik, muzikë folklorike, aktivitete për fëmijë, promovim të historisë dhe destinacioneve lokale, degustime, demonstrime gatimesh tradicionale dhe përfshirje të komunitetit.

## **3. Kush mund të aplikojë?**

Thirrja është e hapur për:

- persona juridikë të regjistruar si organizata jofitimprurëse;
- fondacione dhe shoqata me objekt veprimtarie në fushën e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore, turizmit, zhvillimit komunitar apo promovimit të territorit;
- individë ose persona fizikë të regjistruar në QKB, të cilët kanë objekt veprimtarie të lidhur me organizimin e eventeve, promovimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

Aplikuesit duhet të kenë kapacitete organizative dhe eksperiencë të provueshme në organizimin e aktiviteteve publike, kulturore, artistike, turistike ose promovuese.

## **4. Mënyra e aplikimit**

Projekt-propozimet duhet të adresohen pranë Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Bashkia Durrës.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur pranë Zyrës së Informacionit të Bashkisë Durrës, si dhe/ose në mënyrë elektronike në adresën: [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al).

Subjekti i aplikimit duhet të jetë:

**“Aplikim për Thirrjen nr. 2 për projekt-propozime për vitin 2026”**

## **5. Afati i aplikimit dhe periudha e realizimit**

Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më datë **20 Korrik 2026**.

Periudha e realizimit të aktiviteteve do të jetë nga data **10 Gusht 2026** deri më **30 Shtator 2026**, sipas kalendarit të miratuar dhe marrëveshjeve që do të lidhen me subjektin ose subjektet fituese.

## **6. Vlerësimi i propozimeve**

Projekt-propozimet do të vlerësohen nga Kwshilli Kulturor, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në udhëzimin dhe anekset e kësaj thirrjeje.

Në procesin e vlerësimit do të merren në konsideratë cilësia e konceptit, përputhshmëria me qëllimin e thirrjes, kapacitetet organizative, eksperiencia e mëparshme, realizueshmëria e buxhetit, përfshirja e komunitetit dhe ndikimi në promovimin e Durrësit si destinacion kulturor dhe turistik.

Komisioni mund të vlerësojë propozimet në mënyrë të ndarë sipas aktiviteteve. Një aplikues mund të përzgjidhet për një ose disa aktivitete, ndërsa aktivitete të tjera mund t'u akordohen subjekteve të ndryshme, nëse kjo vlerësohet më e përshtatshme për realizimin cilësor të kalendarit.

## **7. Informacion shtesë**

Për më shumë informacion, aplikuesit mund t'i referohen udhëzimit dhe anekseve të kësaj thirrjeje ose të kontaktojnë Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare pranë Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës fton organizatat, subjektet kulturore, operatorët artistikë dhe aktorët e turizmit të paraqesin propozime cilësore, kreative dhe të realizueshme, në funksion të krijimit të një kalendarit aktiviteteve që respekton traditën, promovon identitetin lokal dhe forcon imazhin e Durrësit si qytet i kulturës, turizmit dhe mikpritjes.